

VENDIM
Nr. 267, datë 1.4.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 72, DATË 28.1.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPALLJEN E ZONËS EKONOMIKE ME STATUSIN “ZONË E
LIRË”, NË SPITALLË, DURRËS DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.
391, DATË 21.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN “ZONË
EKONOMIKE”, NË SPITALLË, DURRËS””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 5, të vendimit nr. 72, datë 28.1.2015 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Ministri përgjegjës për ekonominë, brenda “Zonës së lirë” të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, mund të përcaktojë, me urdhër, një sipërfaqe më të vogël, për të cilën do të kryhen procedurat e përzgjedhjes së zhvilluesit, si dhe, mbi bazën e kërkesës së zhvilluesit, miraton zgjerimin e zonës së lirë të dhënë sipas këtij urdhri, por jo më shumë se 30% të sipërfaqes së dhënë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama